

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VEI BALLKAN”SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën **15.03.2024** (dymijë e njëzet e kater) personat e meposhtem:

- **Z.Bledar Keta**, atesia **Mustafa Keta**, i datelindjes **06.04.1979**, lindur ne Bulqize dhe banues ne Lushnje, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. Personal **H90406004V**;
- **Z.Stefano Bortoli** ,atesia **Giorgio Bortoli**, i datelindjes **08.03.1971**, lindur ne Itali(Vicenza) dhe banues ne Itali, shtetas Italian, madhore e me zotesine e plote per te vepruar,identifikuar prej leternjoftimit Italian me nr **AY8191344**;
- **Z.Aldo Bortoli** ,atesia **Giorgio Bortoli**, i datelindjes **27.11.1977**, lindur ne Itali(Vicenza) dhe banues ne Itali, shtetas Italian, madhore e me zotesine e plote per te vepruar,identifikuar prej leternjoftimit Italian me nr **CA04812LV**;

ne cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", vendosen te themeloje shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **“VEI BALLKAN” SHPK**.

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**



**Neni 1
Emri dhe Ortaket**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” dhe mban emrin **“VEI BALLKAN”SHPK**.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria“VEI BALLKAN” SHPK do te kete objekt veprimtarie:

- 2.1 Shitja dhe instalimi i sistemeve te peshimit, asistence,montim dhe riparim te tyre.
- 2.2 Shitja dhe punim te te gjitha materialeve te ndryshme per ndertim si dhe per industri .
- 2.3 Shitje dhe dhenie me qira te makinerive te ndryshme industriale dhe te tjera , Asistence,montim dhe riparim te tyre.
- 2.4 Import-Eksport te te gjitha produkteve qe lidhen me aktivitetin e shoqerise
- 2.5 Shitje-Blerje te tokave te llojeve te ndryshme ,ndertesa sociale dhe industriale ,dhenia me qira e tyre.



Neni 3
Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria “**VEI BALLKAN**”SHPK gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-se.

Neni 4
Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: **Lagja “Gafurr Muço” ,Rruga “Sulejman Delvina” ,9001 ,Lushnje**
Tel:+355693762277; adresa e shoqërisë me qelime komunikimi elektronik është si vijon: **bbv@vei-italia.it**
- 4.2 Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit perkates.

KREU III
Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar


- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **93,500 Lek**(Nentëdhjetë e tre mijë e pesëqind leke), i barabartë me 3 (tri) kuota. Kontributet e ortakeve përbejnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes të secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve në kapital (leke)	Përqindja në Kapital
1.	Bledar Keta	1	46,750	50%
2.	Stefano Bortoli	1	23,375	25%
3.	Aldo Bortoli	1	23,375	25%
	Totali	3	93,500	100%

- 5.3 **Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakeve të shoqërisë.**

Neni 6
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakeve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakeve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.
- 6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

 Three handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page. The signatures are stylized and appear to be of the individuals mentioned in the text, likely Bledar Keta, Stefano Bortoli, and Aldo Bortoli.

KREU IV
Neni 7
Kuotat dhe Kalimi i Kuotave


- 7.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndermjet paleve.
- 7.2** Transferimi i kuotave të ortakeve të shoqërisë brenda ortakerisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakerisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakeve ekzistues.
- Ortaku, para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zoterojnë në kapital të shoqërisë.
- Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarohen se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij teresisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakerisë.
- Në rast se një pjesë e ortakeve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarohen se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar të transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë (dmth në rast se dy ortak shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do të shiten të dy ortakeve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).

Neni 8
Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3** Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Kreu IV
Asambleja e Përgjithshme
Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese së Përgjithshme



- 9.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
 - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
 - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
 - n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkrese, me postë ose e -mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithë ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohën, vendin dhe rendin e dites te mbledhjes,se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithë Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10 **Kuorumi i nevojshem**

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 31 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2** Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

- 11.1** Asambleja e Ortakeve vendos me 3/4 të ortakëve zoterues të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.



- 11.5 Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 12

Votat e Ortakëve

- 12.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi.
- 12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V

Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve ne Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë“**VEI BALLKAN**” SHPK
- **Z.Bledar Keta**, atesia **Mustafa Keta**, i datelindjes **06.04.1979**, lindur ne Bulqize dhe banues ne Lushnje, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. Personal **H90406004V**, **per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Biznesit.**

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar ne fuqi.
- 14.2 Pa u kufizuar sa me sipër, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetenca:
- do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
 - do te nenshkruaje cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
 - do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj,
 - do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijojte nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e

Bledar Keta

- parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
- (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise – duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
 - (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
 - (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
 - (viii) do te krijojte nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
 - (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”;
 - (x) do t’i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
 - (xii) do te marre ne pune, emerose, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktojte kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktojte shperblimin e tyre;
 - (xi) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15


Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-afetise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit



- 16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqërite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në baze të kuorumit të kërkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Kreu VI
Prishja dhe njoftimet
Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përcaktueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqërite tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

17.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-se.

Neni 18
Njoftimet

18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e



parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19 Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilët i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

NENI 20 Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilesuar të percaktuar me sipër.
- 20.2** Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do të referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga ortakut themelues pa asnjë rezervë.

ORTAKET THEMELUES

Bledar Keta

Bledar Keta

Stefano Bortoli

STEFANO BORTOLI

Aldo Bortoli

BORTOLI ALDO